



Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë-QKSS
Raporti i auditorit të pavarur dhe pasqyrat financiare
Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2019

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë-QKSS

PËRMBAJTJA	FAQE
RAPORTI I AUDITORIT	3
BILANCI I GJENDJES	5
PASQYRA E TË ARDHURAVE	6
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET	7
PASQYRA E RRJEDHJES SË PARASË SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE	8 12-20



RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Menaxhmentit të Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë-QKSS

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare shoqëruese të Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë-QKSS, që përfshinë Pasqyrën e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2019, Pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, Pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe Pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin që ka përfunduar, si dhe një përmbledhje të politikave të kontabilitetit dhe shënimeve tjera shpjeguese.

Sipas mendimit tonë pasqyrat financiare të Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë-QKSS paraqesin drejtë, në të gjitha çështjet materiale pozicionin financiar të fondacionit më 31 Dhjetor 2019, dhe performancën e saj financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin që ka përfunduar në përputhshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Baza për Opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në seksionin e raportit Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Kompania në përputhje me Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionistë (Kodit IESBA), dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tjera etike në përputhje me Kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe atyre të ngarkuar me Qeverisjen e Pasqyrave Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në pajtueshmëri me Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar dhe për kontrollat e brendshme të cilat menaxhmenti i vlerëson të nevojshme për të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësinë së organizatës për vazhdueshmërinë në të ardhmen, duke shpalosur, sipas nevojës, çështjet lidhur me vazhdueshmërinë në të ardhmen dhe përdorimit të parimit të vazhdueshmërisë së kontabilitetit përveç nëse menaxhmenti synon të likuideojë organizatën apo të ndërpres operimin, apo nuk ka ndonjë alternativ tjetër të mundshme përveç se të bëjë atë. Ata të cilët janë ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të organizaës.

Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë të lira nga gabimet materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të nxjerrë një raport të auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk ka garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të gjithmonë do të zbulojë gabime materiale kur ato ekzistojnë. Gabimet mund të rrjedhin nga mashtrimet apo gabimet dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose në total, ato në mënyrë të arsyeshme mund të pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticismin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e gabimeve materiale në pasqyrat financiare, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dizajnojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit të përshtatshme për këto rreziqe, dhe marrim dëshmi të auditimit të mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të gabimeve materiale që rezultojnë nga mashtrimi është më i lartë se atij që rrjedh nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrolleve të brendshme.

I kuptojmë kontrollet e brendshme relevante për auditimin me qëllim të hartimit të procedurave të auditimit që janë të përshtatshme në rrethanat, por jo për qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të Kompanisë.

I vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjet relevante të bëra nga menaxhmenti.

Konkludojmë mbi përshtatshmërinë e përdorimit të parimit të vazhdueshmërisë së kontabilitetit nga menaxhmenti, duke u bazuar në dëshmitë e siguruar të auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston në lidhje me ngjarjet apo kushteve që mund të hedhë dyshime të konsiderueshme mbi aftësinë e organizatës për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për shpalosjet relevante në pasqyrat financiare apo, nëse shpalosjet e tilla janë të papërshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë që kompania të pushojë së vazhduari në vijimësi.

Ne komunikojmë me ata të ngarkuar me qeverisje lidhur me, në mesin e çështjeve tjera, qasjen e planifikuar dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollet e brendshme që kemi identifikuar gjatë auditimit.



“Univerzum Audit” Sh.p.k.
Besa Berisha-Partnere
Tel. +38344124898
Q.T. Bregu i Diellit, lok. 26
Prishtinë, Kosovë

Tetor, 2020

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë-QKSS
Pasqyra e Pozicionit Financiar
Për fundin e vitit më 31 dhjetor 2019

	Shënimi	Më 31 Dhjetor 2019 (në EUR)	Më 31 Dhjetor 2018 (në EUR)
Pasuritë			
Pasuritë qarkulluese			
Paraja në bankë	4	132,073	62,714
Paraja në arkë		16	-
Parapagimet		3,600	
Totali i pasurive qarkulluese		135,689	62,714
Asetet jo-qarkulluese			
Prona, paisjet dhe impiantet		0	0
Totali i aseteve jo-qarkulluese		0	0
TOTALI I ASETEVE		135,689	62,714
DETYRIMET DHE EKUITETI			
Detyrimet rrjedhëse			
Ll. e pagueshme dhe shpenzimet akruale	5	4,108	2,198
Të hyrat e shtyera	6	128,638	58,268
Detyrimet për tatime dhe kontribute	5	2,883	2,248
Detyrimet për tatim në qira	5	59	
Totali i detyrimeve rrjedhëse		135,688	62,714
Ekuiteti			
Fitimi i mbajtur			
Profit/Humbja neto e vitit			
Totali i ekuitetit		0	0
TOTALI I DETYRIMEVE DHE EKUITETIT		135,688	62,714

Pasqyrat financiare janë nënshkruar më 15 maj 2020 nga:

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë-QKSS
 Pasqyra e të ardhurave
 Për fundin e vitit më 31 dhjetor 2019

		Fundi i vitit 31 Dhjetor 2019 (në EUR)	Fundi i vitit 31 Dhjetor 2018 (në EUR)
Të hyrat			
Të hyrat	7	311,956	236,440
Totali i të hyrave		311,956	236,440
Shpenzimet			
Shpenzimet e pagave		133,232	172,352
Shpenzimet administrative		90,244	75,509
Shpenzimet tjera operative		7,912	7,912
Totali i shpenzimeve	8	231,388	255,773
Teprica/mungesa e të hyrave ndaj shpenzimeve		80,856	-19,333

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë-QKSS
Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet
Për fundin e vitit më 31 dhjetor 2019

	Mbetja (në EUR)	Totali i mbetjes (në EUR)
	<u>2019</u>	<u> </u>
Mbetja e fundit të vitit më 31 Dhjetor 2018	-	-
Gjendja më 31 Dhjetor 2018	<u>-</u>	<u>-</u>
Mbetja e fundit të vitit më 31 Dhjetor 2019	-	-
Gjendja më 31 Dhjetor 2019	<u>-</u>	<u>-</u>

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë-QKSS
 Pasqyra e rrjedhës së parasë
 Për fundin e vitit më 31 dhjetor 2019

	Fundi i vitit 31 Dhjetor 2019 (në EUR)	Fundi i vitit 31 Dhjetor 2018 (në EUR)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operuese		
(Deficiti)/surplusi gjatë periudhës	80,569	-
Rregulluar për:		
Zhvlersimin	-	-
Obligimet ndaj donatorit		
Ndryshimet në të arkëtueshme		
Ndryshimet në të pagueshme	(10,376)	
Ndryshimet në detyrime tjera	(818)	
Paratë e gjeneruara nga operimet	69,375	
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese		
Blerja e pronës dhe e paisjeve		
Paraja neto e përdorur në investime		
Ndryshimet neto në para dhe ekuivalent	69,375	
Paraja dhe ekuivalentet e parasë më 1 Janar	62,714	
Paraja dhe ekuivalentet më 31 Dhjetor	132,089	62,714

1. HYRJJE

Rreth Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë është qendër e pavarur për politika të hulumtimit e themeluar në Prill 2008 në Prishtinë – Kosovë.

Objektivat dhe Synimet Kryesore

QKSS është e dedikuar në zhvillimin e sektorit të sigurisë dhe reformave në Kosovë dhe në Ballkanin Perëndimor. Ajo në mënyrë aktive promovon parimin e qeverisjes së mirë, integritetin dhe elasticitetin. Objektivat Kryesore dhe Qëllimet Themeluar në 2008, interesi kryesor i QKSS është që të zhvillohet sektori i sigurisë në Kosovë dhe në Ballkanin Perëndimor duke u bazuar në qeverisje të mirë. Përreth një dekadë, QKSS ka ndërtuar dhe ofruar ekspertiza alternative në studimet e sigurisë, duke plotësuar një boshllëk në një kontribut të kufizuar akademik në këtë fushë në Kosovë.

QKSS synon të rrisë efektivitetin duke mbështetur programet RSS nëpërmjet hulumtimeve, ngjarjeve, trajnimeve, avokimeve dhe këshillave të drejtpërdrejta të politikës. Avancimi i ideve të reja dhe metodave të shkencave sociale janë gjithashtu vlerat thelbësore të qendrës.

Çdo vit, QKSS publikon një numër të madh të raporteve, dokumente të politikave dhe dokumente të shkurtra të politikave. Gjithashtu, mban më shumë se 200 evente publike duke përfshirë konferenca, tryeza të rrumbullakëta, debate dhe ligjërata në Kosovë, gjithashtu edhe në bashkëpunim me partnerët regjional dhe ndërkombëtar. Një sferë e gjerë e aktiviteteve duke përfshirë hulumtimet, ndërtimin e kapaciteteve, ndërgjegjësimin dhe avokimin.

QKSS mbështet konsolidimin e zhvillimit të sektorit të sigurisë në Kosovë, në rrugën e saj drejt integriteteve euroatlantike, kryesisht nëpërmjet aktiviteteve të mëposhtme:

- Hulumtime dhe Dokumente të Politikave
- Rekomandim për politika dhe Avokim
- Ekspertiza Alternative në sfidat bashkëkohore të
- Konferenca dhe Diskutime Publike mbi çështjet e sigurisë
- Lidhjet në mes të gjithë akterëve relevant në Kosovë
- Angazhimi i Komunitetit dhe elasticiteti
- Lidhja dhe ndërtimi i fortë i partneriteteve me Think-Tank përkatës dhe institucionet akademike në rajon dhe në nivel global.

Programet e Specializuara të QKSS-së

Programet e specializuara të QKSS kryen analiza të pavarura dhe rigorozë të sfidave kritike globale, rajonale dhe specifike të vendit si dhe mundësitë. Raportet tona, librat, dokumente dhe hulumtimet kërkimore janë burim vital për udhëheqësit dhe politikëbërësit në qeveri, në sektorin privat dhe në shoqërinë civile. Për më shumë, ato shërbejnë si burim i informacionit për partnerët tanë ndërkombëtar.

QKSS ka zhvilluar 4 programe kryesore të hulumtimit, si në vijim:

- Kundërvënien dhe Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm
- Ndërtimi i Integritetit në Sektorin e Sigurisë • Bashkëpunimi Rajonal në Sektorin e Sigurisë, dhe anëtarësimi në strukturat Euro-Atlantike
- Barometri Kosovar i Sigurisë

2. ADAPTIMI I STANDARTEVE TË RISHIKUARA DHE STANDARDEVE TË REJA

2.1 Standardet, amendamentimet dhe interpretimet efektive në këtë periudhë

Më poshtë janë paraqitur ndryshimet në standardet ekzistuese të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe interpretimet e nxjerra nga Komiteti i Interpretimeve të Raportimit Financiar të cilat janë në fuqi për periudhën aktuale:

Standardi	Përshkrimi	Data efektive
SNRF 1	Përmirësimet vjetore në SNRF të ciklit 2014-2016	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2018
SNK 28	Përmirësimet vjetore në SNRF të ciklit 2014-2016	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2018
SNRF 15	Të ardhurat nga kontratat me klientët	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2018
SNRF 9	Instrumentet financiare	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2018
Amandament në SNK 40	Transferimi i pronës së investimeve (Ndryshimet në SNK 40)	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2018
SNRF 4	Aplikimi i SNRF 9 Instrumentet Financiarë me SNRF 4 Kontratat e Sigurimit (Ndryshimet në SNRF 4)	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2018
Amandamentet në SNRF 2	Klasifikimi dhe matja e bazuar në aksione Transaksionet e Pagesave (Ndryshimet në SNRF 2)	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2018
SNRF 16	Qiratë	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2019
Amandamentet në SNRF 9	Karakteristikat e parapagimit me kompensim negativ (Ndryshimet në SNRF 9)	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2019
Amandament në SNK 28	Interesat afatgjatë në pjesëmarrje dhe ndërmarrje të përbashkëta (Ndryshimet në SNK 28)	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2019
SNK12, SNK 13, SNRF 3 dhe SNRF 11	Përmirësimet vjetore në SNRF të ciklit 2015-2017	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2019
Amandament në SNK 19	Plani i ndryshimit, mbylljes ose zgjidhjes (Ndryshimet në SNK 19)	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2019

2.2 Standardet, amendamentimet dhe interpretimet jo efektive në këtë periudhë

Në këto pasqyra financiare, standardet, rishikimet dhe interpretimet e mëposhtme akoma nuk janë efektive:

Standardi	Përshkrimi	Data efektive
	Korniza konceptuale për Raportim Financiar	që fillojnë më apo pas 1 Janar 2020
Amandament në SNRF 3	Përkufizimi i një biznesi (Ndryshimet në SNRF 3)	që fillojnë më apo pas 1 Janar 2020
Amandamente në SNK 1 dhe SNK 8	Përkufizimi i materialit (Ndryshimet në SNK 1 dhe SNK 8)	që fillojnë më apo pas 1 Korrik 2020
SNRF 9, SNK 39, and SNRF 7	Reforma e standardit të normës së interesit	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2020
SNRF 17	Kontratat e sigurimeve	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2021
Praktike Deklarata 2	Zhvillimi i gjykimeve për materialitetin	Asnjë datë efektive si udhëzime jo të detyrueshme

Organizata ka vendosur të mos i adaptojë këto standarde, rishikime dhe interpretime përpara datave efektive të tyre. Organizata parashikon që adaptimi i këtyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare të subjektit në periudhën e zbatimit fillestar.

3. BAZA E PËRGATITJES DHE POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL

3.1 Baza e përgatitjes

Pasqyrat financiare të bashkangjitura janë përgatitur për qëllime të raportimit në përputhje me ligjet e aplikueshme në Kosovë, dhe paraqesin një pasqyrë të plotë të ngjarjeve ekonomike që kanë ndodhur në Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë-QKSS më 2019.

3.2 Valuta e përdorur

Valuta e përdorur për raportim nga ana e Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë-QKSS është valuta e bashkësisë evropiane Euro ("EUR").

3.3 Politikat e rëndësishme të kontabilitetit

Një përmbledhje e politikave më të rëndësishme të kontabilitetit të përvetsuara për pregaditjen e pasqyrave financiare janë prezentuar më posht:

3.3.1 Paraja dhe ekuivalentet e parasë

Për qëllime të pasqyrës së rrjedhës së parasë, parja dhe ekuivalentet e parase janë konsideruar të jenë paraja e gatshme si dhe ajo në llogari rrjedhëse, si dhe paraja me maturitet jo më shume se tre muaj.

3.3.2 Njohja e të hyrave

Të hyrat nga grantet janë njohur si të hyra për periudhën të cilës i takojnë. Në fund të vitit mbetja e të ardhurave mbi shpenzimet trajtohet si suficit.

3.3.3 Njohja e shpenzimeve

Shpenzimet e ndodhura për gjenerimin e të hyrave janë njohur në periudhën përkatëse në bazë të kostos historike.

3.3.4 Tatimet

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë-QKSS është e regjistruar si organizatë jo-profitabile nën rregulloret e Kosovës, dhe e posedon statusin e beneficuar si OJQ, prandaj është e përjashtuar nga tatimi mbi korporata mbi të tepricën e të hyrave ndaj shpenzimeve.

4. PARAJA DHE GJENDJA NË BANKA

	31 Dhjetor 2019 (në EUR)	31 Dhjetor 2018 (në EUR)
Paraja e gatshme	16	
Paraja në bankë:	132,072	62,714
Totali parasë dhe gjendjes në bankë	132,088	62,714

5. LLOGARITË E PAGUESHME DHE SHPENZIMET AKRUALE

	31 Dhjetor 2019 (në EUR)	31 Dhjetor 2018 (në EUR)
Llogarite e pagueshme tregtare dhe te tjera	4,108	2,198
Detyrimetb për tatime dhe kontribute	2,883	2,248
Detyrimi për tatim në qira	59	
Totali I llogarise se pagueshme	7,050	4,446

6. TË HYRAT E SHTYERA

	31 dhjetor, 2019 (në EUR)	31 dhjetor, 2018 (në EUR)
Të hyrat e shtyera	128,638	58,268
Totali i të hyrave të shtyera	128,638	58,268

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë-QKSS
 Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
 Për fundin e vitit më 31 dhjetor 2019

7. TË HYRAT SIPAS PROJEKTEVE	01.01.2019-31.12.2019
Projektet nga donatorë të ndryshëm	260,378
Projekti NED	41,578
Projekti MATRA	0
Projekti KFOS	10000
Projekti DSP	0
Projekti US	0
Projekti NATO	0
Projekti RESOLVE	0
Projekti OSI	0
Total të hyrat	311,956

8. TË HYRAT DHE SHPENZIMET SIPAS DONATORËVE
 Donatorët: NED, Ambasada Amerikane në Prishtinë, UNODC, SYNYO GMBH, IDSCS,
 Berghof Founadtion, German Marshal Fund, NATO Public Diplomacy Division

01.01.2019 - 31.12.2019	
<u>TË HYRAT</u>	260,378

SHPENZIMET

Shpenzimet e akomodimit	4,644
Shpenzimet e auditimit	800
Shpenzimet e derivateve	2,685
Shpenzimet e furnizimit	828
Shpenzimet e kontabilitetit	100
Shpenzimet e internetit	240
Shpenzimet per blerje te vetures	6,435
Shpenzimet e mbeturinave	34
Shpenzimet e mirembajtjes	9,800
Shpenzimet e mirembajtjes se automjetit	1,120
Shpenzimet e ndryshme	3,235
Shpenzimet e ngrohjes	276
Shpenzimet e pagave	100,274
Shpenzimet e perkthimeve	7,064
Shpenzimet e postes	32
Shpenzimet e printimit	874
Shpenzimet e provizioneve	648
Shpenzimet e qirase	7,200
Shpenzimet e rrymes	33
Shpenzimet e sigurimit ne udhetim	242
Shpenzimet e sigurimit te automjeteve	255

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë-QKSS
 Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
 Për fundin e vitit më 31 dhjetor 2019

Shpenzimet e udhëtimit - huazim I vetures	408
Shpenzimet e udhëtimit lokal	5,012
Shpenzimet e ujit	6
Shpenzimet per pije ne sallën e konferencave	2,819
Shpenzimet per reklame	1,490
Shpenzimet per salla	8,039
Shpenzimet e tatimit ne qira	356
Shpenzimet per pajisje kompjuterike	25
Total shpenzime	164,975
Neto fitimi/ humbja e bartur	95,403

Projekti NED

01.01.2019 - 31.12.2019

TË HYRAT 41,578

SHPENZIMET

Shpenzimet e derivateve	650
Shpenzimet e furnizimit	691
Shpenzimet e kontabilitetit	1,100
Shpenzimet e mbeturinave	25
Shpenzimet e mirembajtjes	1,285
Shpenzimet e ndryshme	1,594
Shpenzimet e ngrohjes	195
Shpenzimet e pagave	11,812
Shpenzimet e perkthimeve	3,051
Shpenzimet e printimit	1,934
Shpenzimet e provizioneve	383
Shpenzimet e rrymes	118
Shpenzimet e udhëtimit - huazim I vetures	436
Shpenzimet e ujit	82
Shpenzimet per pije ne sallën e konferencave	493
Shpenzimet per salla	674
Shpenzimet e tatimit ne qira	356
Shpenzimet per pajisje kompjuterike	390
Total shpenzime	25,271
Neto fitimi/humbja e bartur	16,308

Projekti MATRA	
01.01.2019 - 31.12.2019	
<u>TË HYRAT</u>	0
<hr/>	
<u><i>SHPENZIMET</i></u>	
Shpenzimet e derivateve	30
Shpenzimet e furnizimit	137
Shpenzimet e mbeturinave	48
Shpenzimet e mirembajtjes	4,562
Shpenzimet e ndryshme	848
Shpenzimet e ngrohjes	272
Shpenzimet e pagave	13,810
Shpenzimet e perkthimeve	4,567
Shpenzimet e printimit	50
Shpenzimet e proizioneve	65
Shpenzimet e rrymes	35
Shpenzimet e udhetimit - huazim I vetures	30
Shpenzimet e ujit	11
Shpenzimet per pije ne sallen e konferencave	957
Shpenzimet per salla	5,901
Shpenzimet per pajisje kompjuterike	135
<i>Total shpenzime</i>	<i>31,458</i>
<i>Neto fitimi/humbja</i>	<i>-31,458</i>

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë-QKSS
 Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
 Për fundin e vitit më 31 dhjetor 2019

Projekti KFOS	
01.01.2019 - 31.12.2019	
<u>TË HYRAT</u>	10,000
<hr/>	
<u><i>SHPENZIMET</i></u>	
Shpenzimet e furnizimit	20
Shpenzimet e provizioneve	11
Shpenzimet e pagave	6,226
<i>Total shpenzime</i>	<i>6,257</i>
Neto fitimi/ humbja e vitit	3,743

Projekti DSP	
01.01.2019 - 31.12.2019	
<u>TË HYRAT</u>	0
<hr/>	
<u><i>SHPENZIMET</i></u>	
Shpenzimet e pagave	1,110
Shpenzimet e përkthimeve	80
Shpenzimet e provizioneve	9
<i>Total shpenzime</i>	<i>1,199</i>
Neto fitimi/humbja e bartur	-1,199

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë-QKSS
 Shënime të pasqyrave financiare (vazhdim)
 Për fundin e vitit më 31 dhjetor 2019

Projekti US	
01.01.2019 - 31.12.2019	
<u>TË HYRAT</u>	0
<hr/>	
<u><i>SHPENZIMET</i></u>	
Shpenzimet e furnizimit	62
Shpenzimet e mbeturinave	8
Shpenzimet e ujit	8
<hr/>	
<i>Total shpenzime</i>	<i>78</i>
Neto fitimi /humbja e vitit	-78

Projekti NATO	
01.01.2019 - 31.12.2019	
<u>TË HYRAT</u>	0
<hr/>	
<u><i>SHPENZIMET</i></u>	
Shpenzimet e udhëtimit	867
<hr/>	
<i>Total shpenzime</i>	<i>867</i>
Neto fitimi/humbja e bartur	-867

Projekti RESOLVE	
01.01.2019 - 31.12.2019	
<u>TË HYRAT</u>	0
<hr/>	
<u><i>SHPENZIMET</i></u>	
Shpenzimet e udhëtimit	32
<hr/>	
<i>Total shpenzime</i>	<i>32</i>
Neto fitimi /humbja e bartur	-32

Projekti OSI	
01.01.2019 - 31.12.2019	
<i><u>TË HYRAT</u></i>	0
<hr/>	
<i><u>SHPENZIMET</u></i>	
Shpenzimet e akomodimit	1,253
<hr/>	
<i>Total shpenzime</i>	<i>1,253</i>
Neto fitimi/humbja e bartur	-1,253

9. PALËT E NDËRLIDHURA

Për qëllime të këtyre pasqyrave financiare, palët konsiderohen të ndërlidhura nëse njëra prej tyre ka mundësinë të kontrolloj palën tjetër, apo nëse njëra prej tyre ka ndikim në palën tjetër gjatë marrjes së vendimeve financiare apo operuese sic është cekur në SNK 24 "Shpalosja e palëve të ndërlidhura". Në vështrimin e mundësisë së ekzistimit të palëve të ndërlidhura, vëmendja është përqëndruar në aspektin e marrëdhënies e jo në aspektin legal.

10. MENAXHIMI I RISKUT

Kredit risku

Kredit Risku është risku që njëra palë me dështimin në përmbushjen e obligimeve financiare do ndikojë në palën tjetër të ketë humbje financiare. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë-QKSS nuk i është ekspozuar kredit riskut në aspektin e granteve që i ipen organizatave me të cilat bashkëpunon.

Risku nga kamatat

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë-QKSS momentalisht nuk i është ekspozuar riskut nga kamatat bankare.

Risku nga këmbimet ndërkombëtare

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë-QKSS është ekspozuar nga këmbimet ndërkombëtare pasi që transaksionet ndodhin në valutë vendore dhe të huaj.

Risku i likuiditetit

Risku i likuiditetit paraqet riskun kur pjekuria e pasurisë dhe e detyrimeve nuk përputhen. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë-QKSS monitoron likuiditetin e sajë në baza periodike, në mënyrë që të menaxhoj obligimet e sajë në momentin kur duhet të paguhet.